SH.F.K
GJERGJ KASTRIOTI
SKENDERBEU
HARAÇINË

LAJMËRIM

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË KLASË TË PARË - VITI SHKOLLOR 2024-2025

Të nderuar prindër drejtoria e shkollës fillore komunale "Gjergj Kastrioti Skenderbeu"- Haraçinë ju informon se duke filluar nga data 09.05.2024, do të fillojë me regjistrimin e nxënësve në klasë të parë për vitin shkollor 2024-2025!

Kushtet për regjistrim janë:

Në klasë të parë do të regjistrohen të gjithë femijët të cilët deri më 31.12.2024 (viti i lindjes 2018) i mbushin 6 vjet.

Në klasë të parë mund të regjistrohen edhe femijet e lindur deri më 31.01.2019 me kërkesë nga prindi/kujdestari dhe mendim nga sherbimi profesional.

Regjistrimi do të bëhet si vijon: Çdo ditë pune nga dita e hëna deri të premten nga ora **09:00 deri në ora 13:00.**

Dokumentet e duhura për regjistrim:

- Çertifikata e lindjes (kopje);
- Vërtetim për vaksinat e pranuara nga institucioni kompetent shëndetësor;
- Vërtetim nga dentisti institucioni kompetent shëndetësor (Poliklinika "QENTO");
- Vërtetim nga Oftamologu (mjeku i syve) institucioni kompetent shëndetësor;
- Letërnjoftim (fotokopje) të njërit prind ose kujdestarit.

Për fëmijët me nevoja të veqanta nevojitet edhe mendim nga komisioni për mbështetje arsimore dhe sociale sipas KNF-së.

Për regjistrimin e fëmijës në klasë të parë prezenca e më së paku njerit prind është e domosdoshme.

Për informata plotësuese paraqituni te shërbimi pedagogjik i shkollës.

Suksese të gjithë nxënësve në vitin shkollor 2024-2025!

SHFK "GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" HARAÇINË
U.D DREJTORI
Xhavit Imeri